



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.214/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e Valon Gjabali, për shkak të vendosjes së billbordeve në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2019, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqja e ankesës A.nr.214/2019 e datës 04.10.2019, e parashtruar nga Valon Gjabali, për shkak të vendosjes së billbordeve në rrugë publike.

Arsyetim

Valon Gjabali me datën 04.10.2019 ka paraqitur ankesë në PZAP Anr.214/2019, me të cilin ka kërkuar që të hiqen billbordet nga rrugët publike në Komunën e Prizrenit

Me datë 04.10.2019, ankuesi ka parashtruar kërkesën me nr. Protokolli 214/3 për tërheqjen e ankesës Anr.214/2019 të datës 04.10.2019.

Paneli, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, dhe nenin 33.1 pika k ka vërtetuar se është se ankesa e paraqitur në emër të Organizatës “ec më ndryshe” shifet se është abuzuar me ankesë, se njëjta organizate në përgjigje në ankesë ka vërtetuar se dikush ka keqpërdorur emrin e kësaj organizate nga individ te caktuar dhe njeherit kanë dëshmuar se nuk kane bere asnjë ankesë ndaj subjekteve garuese te zgjedhjeve të 06 Tetorit 2019, siç pretendohet ne ankesë.

PZAP në kuptim të nenit 6 pika 2 të Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it parashihet se *Deri në marrjen e vendimit kryesor, për shqyrtimin e apelit, palët mund të tërheqin apelin e parashtruar*, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.214/2019 më datën 05.10.2019.

Kryesuese e Panelit
Zyhdi Haziri

